



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 21

Tiranë – E mërkurë, 9 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 1/2022, datë 27.1.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 35, datë 24.12.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, ‘Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme’, të ndryshuar”..... 2675
Dekret i Presidentit nr. 13456, datë 4.2.2022	Për shpallje ligji..... 2675
Ligj nr. 4/2022, datë 27.1.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe <i>Kfw Frankfurt Am Main (Kfw)</i> , për rehabilitimin me efikasitet energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri..... 2675
Dekret i Presidentit nr. 13458, datë 4.2.2022	Për shpallje ligji..... 2688
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 9.2.2022	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për Organet e Vetëqeverisjes Vendore, të datës 6 mars 2022..... 2689
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.1.2022	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022..... 2689
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 22, datë 2.2.2022	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 2692
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1395, datë 3.2.2022	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 2693

Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 6, datë 2.2.2022	Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat.....	2693
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 7, datë 2.2.2022	Për miratimin e rregullores “Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave”.....	2694
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 26.1.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.....	2702
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 26.1.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar.....	2703
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 26.1.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar.....	2704
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 26.1.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2021.....	2705
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 58/3, datë 7.2.2022	Për shpronësim për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban i ambienteve rekreative, restaurimi i fasadave të objekteve, në lagjen ‘5 Shtatori’, Çorovodë”.....	2706

**LIGJ**
Nr. 1/2022

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 35, DATË
24.12.2021, “PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË LIGJIN NR. 90/2019, ‘PËR
RIVLERËSIMIN E PASURISË SË
PALUAJTSHME’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 35, datë 24.12.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, ‘Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme’, të ndryshuar”.

Miraturar në datën 27.1.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13456, datë
4.2.2022, të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 13456, datë 4.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 1/2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 35, datë 24.12.2021, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, ‘Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 4/2022

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (HUAMARRËSI),
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË, DHE
KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
REHABILITIMIN ME EFIÇENCË
ENERGJETIKE TË KONVIKTEVE
STUDENTORE TË UNIVERSITETEVE
PUBLIKE NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për rehabilitimin me efikasitet energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.1.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13458, datë
4.2.2022, të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta.**

**MARRËVESHJE HUAJE**

DATE 30 SHTATOR 2021, NDËRMJET
KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(HUAMARRËSI), PËR SHUMËN
20,000,000.00 EURO,
REHABILITIMI ME EFIÇENCË
ENERGJETIKE TË KONVIKTEVE
STUDENTORE TË UNIVERSITETEVE
PUBLIKE NË SHQIPËRI

BMZ-nr. 2019 68 627

Huaja nr. 29755

PËRMBAJTJA

Preambulë

1. Huaja
 2. Disbursimi
 3. Tarifat
 4. Interesi
 5. Pagesa dhe parapagimi
 6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
 7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
 8. Paligjshmëria
 9. Kostot dhe tarifat publike
 10. Detyrimet e veçanta
 11. Zgjidhja e Marrëveshjes
 12. Përfaqësimet dhe deklaratat
 13. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Projektin
 14. Dispozita të përgjithshme
- Shtojca 1. Grafiku i disbursimeve
Shtojca 2. Akti i përputhshmërisë

PREAMBULË

Baza e kësaj Marrëveshjeje Huaje, e lidhur ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit (Marrëveshja ose Marrëveshja e Huas), është nota verbale për Bashkëpunimin Financiar (BF) (Nota Verbale) e datës 9 maj 2019, drejtuar qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

KfW-ja do të rifinancojë huan e dhënë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencion interesi, nga fondet e buxhetit me interes të ulët të ofruara nga Republika Federale

e Gjermanisë, për projektet që plotësojnë kriteret e zhvillimit dhe politikës. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së, të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes, për njohje si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Për të plotësuar fondet e ofruara nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Komisioni Evropian ka vënë në dispozicion përmes KfW-së fonde shtesë sipas Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP). Si rrjedhojë, KfW-ja dhe Huamarrësi synojnë të lidhin një marrëveshje të veçantë granti deri në shumën 4,785,067.87 euro, për financimin e pjesshëm të Projektit (siç përkufizohet më poshtë) (Marrëveshja e Grantit e KIBP-së).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë garanci për Huan, KfW-ja do të japë një hua në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja i ofron Përfituesit një Hua deri në shumën 20,000,000.00 euro (Huaja) (me fjalë: njëzet milionë euro).

1.2 Qëllimi. Huamarrësi e përdor Huan vetëm për rehabilitimin me efikasitet energjetike të konvikteve të Universitetit të Tiranës, faza IV. Krahas kësaj, një pjesë e Huas do të përdoret për ndërtimin e disa godinave të reja nga Master Plani i Qytetit Studenti 1 (Projekti). Detajet e Projektit, si dhe furnizimet apo shërbimet që do të financohen nga Huaja do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë, e cila do të nënshkruhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Ministria e Zbatimit të Projektit ose MZP-ja) dhe KfW-ja, si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia e Tiranës (Marrëveshja e Veçantë) pasi të jetë lexuar dhe dakordësuar.

1.3 Taksat, tarifat dhe detyrimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike të Huamarrësit, si dhe tarifatat doganore nuk financohen nga Huaja.

2. Disbursimi

2.1 Kërkesat për disbursim. Sapo të përmbushen kushtet paraprake sipas nenit 2.3 (Kushtet paraprake të disbursimit), KfW-ja do të disbursojë Huan, në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Huamarrësit. Disbursimet kryhen në përputhje me Grafikon e Disbursimeve (Grafiku i disbursimeve) në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja i



kryen disbursimet deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuar në Shtojcën 1. Kur MZP-ja kërkon disbursimin e shumave më të vogla brenda këtyre periudhave, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në çdo periudhë pasardhëse. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime prej më pak se 200,000.00 euro.

2.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve.* KfW-ja gëzon të drejtën ta refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor 2026.

2.3 *Kushtet paraprake të disbursimit.* KfW-ja është e detyruar t'i kryejë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse kushtet paraprake janë përmbushur, sipas KfW-së, në nivel të kënaqshëm në formë dhe përmbajtje:

a) Huamarrësi duhet t'i tregojë KfW-së, duke i paraqitur opinionin ligjor dhe kopje të certifikuara (secila prej tyre duhet të ketë përkthimin zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të gjithë dokumenteve mbi të cilat referohet opinionin ligjor, se Marrëveshja e Huas është plotësisht efektive dhe e zbatueshme nga pikëpamja ligjore dhe duhet të vërtetohet në mënyrë të veçantë se:

i. Huamarrësi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e të drejtës kushtetuese dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme, që lidhen me detyrimet e tij në kuadër të kësaj Marrëveshjeje; dhe se

ii. KfW-ja është përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi burim nga interesat, detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Shqipëri gjatë dhënies së Huas;

b) KfW-ja zotëron origjinalin e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Veçantë, ku secila është nënshkruar ligjërisht;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 12.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit) janë marrë nga KfW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë, e përmendur në nenin 7 (Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë), ka fuqi dhe efekt të pakufizuar;

e) Huamarrësi e ka paguar Tarifën e Menaxhimit të përcaktuar në nenin 3.2 (Tarifa e menaxhimit);

f) nuk ka ndodhur ose nuk rrezikon të ndodhë asnjë arsye ose incident që do të

përbënte shkak për zgjidhjen e marrëveshjes nëpërmjet një njoftimi, përfundimi afati, vërtetimi ose përmbushjeje kushti (arsyeja e mundshme për zgjidhje); dhe

g) nuk ka lindur asnjë rrethanë e jashtëzakonshme që përjashton ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës së Huamarrësit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

KfW-ja gëzon të drejtën që para çdo disbursimi nga Huaja të kërkojë dokumente dhe prova të mëtejshme, që çmohen të nevojshme për të vlerësuar përmbushjen e kushteve paraprake për disbursimin e specifikuar në këtë seksion.

2.4 *Detajet e procedurës së disbursimit.* Huamarrësi, i përfaqësuar nga MZP-ja dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit nëpërmjet një Marrëveshjeje të Veçantë, e cila pasi të jetë lexuar dhe dakordësuar, nënshkruhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia e Tiranës dhe në veçanti provat që duhen ofruar nga MZP-ja për të dokumentuar se shumat e Huas së kërkuar po përdoren për qëllimet e dakordësuara.

2.5 *E drejta për të anuluar disbursimet.* Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tij, sipas nenit 10 (Detyrimet e veçanta), Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të Huas së padisbursuar me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së Kompensimit të Mospranimit, sipas dhe siç përkufizohet në nenin 2.6 (Kompensimi i Mospranimit).

2.6 *Kompensimi i Mospranimit.* Nëse Huamarrësi i anulon disbursimet e shumave të Huas për të cilat është përcaktuar norma e interesit sipas nenit 2.5 (E drejta për të anuluar disbursimet), ose nëse kjo shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet në afatin e parashikuar në nenin 2.2 (Afati për kërkimin e disbursimeve), Huamarrësi i paguan menjëherë KfW-së, pas kërkesës së saj, atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto që i është shkaktuar KfW-së si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas (Kompensimi i Mospranimit), përveç kur ky mosdisbursim përbën një shkelje të Marrëveshjes nga KfW-ja. KfW-ja e llogarit shumën e kompensimit të mospranimit dhe ia komunikon



atë Huamarrësit. Kompensimi i Mospranimit përcaktohet duke supozuar që Republika Federale e Gjermanisë nuk parashikon asnjë subvencion interesi për Projektin.

3. Tarifat

3.1 Tarifa e Zotimit Financiar. Huamarrësi paguan një tarifë të parimbursueshme të zotimit financiar prej 0.25% në vit (Tarifa e Zotimit Financiar) për shumën e padisbursuar të Huas.

Tarifa e Zotimit bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmëviti në fund të periudhës 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, kur për herë të parë bëhet e kërkueshme më 15 maj 2022, por jo më parë se në datën përkatëse pas datës kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi sipas nenit 14.9 (Hyrja në fuqi dhe efektiviteti).

Tarifa e Zotimit Financiar llogaritet me efekt prapaveprues për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të disbursimeve të Huas.

3.2 Tarifa e Menaxhimit. Huamarrësi i paguan KfW-së një tarifë menaxhimi të parimbursueshme me një shumë të plotë prej 1.00 % të shumës së Huas së përcaktuar në pikën 1.1 (Shuma) (Tarifa e Menaxhimit).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në datën më të hershme prej këtyre dy datave: i. përpara disbursimit të parë; ose ii. tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose një muaj pas hyrjes në fuqi dhe efekt të kësaj Marrëveshjeje (cilado prej këtyre dy datave në pikën “ii”, që bie më vonë). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë sapo kjo Marrëveshje të jetë nënshkruar, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht, pjesërisht ose nëse nuk është disbursuar.

4. Interesi

4.1 Interesi. Huamarrësi i paguan interesin e mëposhtëm KfW-së:

Norma fikse e interesit e përcaktuar për disbursimin e Huas. Huamarrësi e paguan normën e interesit në përputhje me këto dispozita:

a) *Norma e interesit.* Huamarrësi paguan interes për çdo shumë Huaje të disbursuar në normën (Norma Fikse e Interesit) e përcaktuar nga KfW-ja brenda dy ditësh bankare (siç përkufizohet në

nenin 14.1 (Dita Bankare), përpara disbursimit të shumës përkatëse të Huas dhe ky interes përbëhet nga:

i. Norma e shkëmbimit, e përcaktuar në bazë të faqes *Reuters* “ICAPEURO” ose, nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme apo nuk është e aksesueshme, në faqen e *Bloomberg* “ICAE” (ose në një faqe tjetër që zëvendëson faqen e *Bloomberg* dhe *Reuters* të cituar më lart). Nëse asnjëra prej këtyre faqeve nuk përmban të dhënat e nevojshme ose janë të paaksesueshme, KfW-ja e cakton këtë normë në bazë të kostove efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro për maturitete që përkojnë sa më shumë të jetë e mundur me periudhat përkatëse të normave të interesit;

ii. plus një marzh prej 0.55% (në fjalë: zero presje pesëdhjetë e pesë për qind): në vit që merr parasysh fondet e grantit të vënë në dispozicion nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0 % në vit, Norma Fikse e Interesit do të jetë 0 % në vit.

Në këtë mënyrë, Norma Fikse e Interesit të caktuar do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 5.1 (Grafiku i Pagesave);

b) *Konsolidimi.* Nëse nga Huaja është kryer më shumë se një disbursim, KfW-ja do të konsolidojë normën fikse të interesit për çdo shumë Huaje në një normë të vetme interesi pas çdo disbursim. Norma e konsoliduar Fikse e Interesit përkon me mesataren e ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura në 1/10,000 të një pike përqindjeje, nëse shifra e parë pas presjes është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur në 1/10,000 të një pike përqindjeje nëse shifra e parë pas presjes është e barabartë ose më e madhe se 5, dhe kjo do të shërbejë si bazë për llogaritjet e ardhshme të normës së interesit nga data e çdo disbursimi deri në disbursimin tjetër. Pas disbursimit të plotë të Huas, norma e përcaktuar mesatare fikse e interesit do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 5.1 (Grafiku i Pagesave);

c) *Njoftimi i normës së interesit.* KfW-ja njofton Huamarrësin pa vonesë për Normën Fikse të



Interesit sipas nenit 4.1.a) (Norma e Interesit), menjëherë pasi kjo normë të jetë caktuar. KfW-ja e njofton Huamarrësin për normën e konsoliduar të interesit sipas nenit 4.1.b) (Konsolidimi) në Datën e Ardhshme të Pagesës (siç përcaktohet në nenin 4.3 (datat e pagesës)).

4.2 *Llogaritja e interesit*. Interesi i shumës së Huas së disbursuar llogaritet nga data (duke e përjashtuar atë) kur është disbursuar shuma e Huas nga llogaria e Huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë atë) kur janë kredituar pagesat në llogarinë e KfW-së, të përcaktuara në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Interesi llogaritet në përputhje me nenin 6.1 (Llogaritja).

4.3 *Datat e Pagesës*. Interesi bëhet i kërkueshëm për shlyerje në datat e përcaktuara më poshtë (secila “Datë Pagesë”):

a) para datës së kërkueshme të kështit të pagesës së parë më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më parë se në Datën e Pagesës pas datës kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi sipas nenit 14.10 (Hyrja në fuqi dhe efektiviteti);

b) në datën e kërkueshme të kështit të parë të pagesës sipas nenit 5.1 (Grafiku i Pagesave) së bashku me këtë kësht;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kështeve të pagesës sipas nenit 5.1 (Grafiku i Pagesave).

5. Pagesa dhe parapagimi

5.1 *Grafiku i Pagesave*. Huamarrësi e paguan Huan, si vijon:

	Data e kërkueshme	Kësti i pagesës	
1	15 maj 2026	952.380,95	EURO
2	15 nëntor 2026	952.380,95	EURO
3	15 maj 2027	952.380,95	EURO
4	15 nëntor 2027	952.380,95	EURO
5	15 maj 2028	952.380,95	EURO
6	15 nëntor 2028	952.380,95	EURO
7	15 maj 2029	952.380,95	EURO
8	15 nëntor 2029	952.380,95	EURO
9	15 maj 2030	952.380,95	EURO
10	15 nëntor 2030	952.380,95	EURO
11	15 maj 2031	952.380,95	EURO
12	15 nëntor 2031	952.380,95	EURO
13	15 maj 2032	952.380,95	EURO
14	15 nëntor 2032	952.380,95	EURO
15	15 maj 2033	952.380,95	EURO
16	15 nëntor 2033	952.380,95	EURO
17	15 maj 2034	952.380,95	EURO
18	15 nëntor 2034	952.380,95	EURO
19	15 maj 2035	952.380,95	EURO
20	15 nëntor 2035	952.380,95	EURO
21	15 maj 2036	952.381,00	EURO

Ky grafik pagese mund të përshtatet herë pas here, në përputhje me nenin 5.5 (Grafiku i Rishikuar i Pagesave).

5.2 *Shumat e padisbursuara të Huas*. Shumat e padisbursuara të Huas mund të kompensohen kundrejt kështit të fundit të pagesës, të kërkueshëm sipas grafikut të pagesave të

përcaktuar në nenin 5.1 (Grafiku i Pagesave), përveç kur KfW-ja, në diskrecionin e saj të plotë, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi për raste individuale.

5.3 *Pagesat në rast disbursimi të paplotë*. Nëse një kësht pagese bëhet i kërkueshëm përpara se Huaja të disbursohet plotësisht, kjo nuk ndikon te



Grafiku i Pagesës sipas nenit 5.1 (Grafiku i Pagesës), për sa kohë që kësti i pagesës që bëhet i kërkueshëm është më i vogël se shuma e Huas së disbursuar dhe që nuk është shlyer ende (Shuma e Pashlyer e Huas). Nëse kësti i pagesës që bëhet i kërkueshëm në përputhje me nenin 5.1 (Grafiku i Pagesës) e tejkalon Shumën e Pashlyer të Huas, ky këst pagese reduktohet në nivelin e Shumës së Pashlyer të Huas dhe diferenca shpërndahet në mënyrë të barabartë midis kësteve të pagesës, të cilat nuk janë shlyer ende. Gjatë llogaritjes së Shumës së Pashlyer të Huas, KfW-ja rezervon të drejtën të marrë parasysh disbursimet nga Huaja, të cilat kryen brenda një periudhe 45-ditore ose më të gjatë, para Datës së Pagesës, për të përcaktuar Shumën e Huas së Pashlyer vetëm për Datën e ardhshme të Pagesës.

5.4 Parapagimi. Për parapagimet gjejnë zbatim sa më poshtë:

a) E drejta e parapagimit. Sipas pikave 5.4 “b” (njoftimi) deri në pikën 5.4 “e” (kompensimi), Huamarrësi gëzon të drejtën e pagimit të shumave të Huas para datës së kërkueshme të planifikuar, nëse ky parapagim është të paktën në shumën e kështit të pagesës sipas nenit 5.1 (Grafiku i Pagesave);

b) Njoftimi. Parapagimi i shumës së Huas sipas nenit 5.4 “a” (E drejta e parapagimit) është objekt i njoftimit të parapagimit nga Huamarrësi në favor të KfW-së, jo më vonë se në Ditën e Pesëmbëdhjetë Bankare para datës së planifikuar të parapagimit. Ky njoftim është i pakthyeshëm dhe duhet të caktojë datën dhe shumën e parapagimit, si dhe e detyron Huamarrësin t’i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar;

c) Tarifa e Parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë Huaje me interes fiks, Huamarrësi i paguan menjëherë KfW-së, me kërkesë të saj, shumën e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto që i është shkaktuar KfW-së si rezultat i këtij parapagimi (Tarifa e Parapagimit). KfW-ja e përcakton shumën e Tarifës së Parapagimit dhe ia komunikon Huamarrësit. Tarifa e parapagimit përcaktohet duke supozuar që Republika Federale e Gjermanisë nuk parashikon asnjë subvencion interesi për Projektin. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja i tregon Huamarrësit shumën e Tarifës së Parapagesës përpara

njoftimit të pakthyeshëm të pagesës sipas nenit 5.4 “b” (njoftimi);

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin, sipas nenit 5.4 “a” (e drejta e parapagimit), Huamarrësi paguan edhe shumat e mëposhtme:

i. Çdo Tarifë Parapagimi të kërkueshme si rezultat i parapagimit, sipas nenit 5.4 “c” (Tarifa e Parapagimit); dhe

ii. të gjithë interesin e mbledhur për shumën e Huas së parapaguar dhe çdo pagesë tjetër që është ende e pashlyer, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, që është mbledhur deri në datën e parapagimit;

e) Kompensimi. Neni 5.2 (Shumat e Huas së Padisbursuara) do të zbatohen *mutatis mutandis* për kompensimin pagesave.

5.5 Grafiku i rishikuar i pagesave. Në rast se zbatohet neni 5.3 (pagesat në rast disbursimi të paplotë) ose neni 5.4 (parapagimi), KfW-ja i dërgon Huamarrësit grafikun e rishikuar të pagesave, i cili do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e pagesave të vlefshëm deri në atë datë.

6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

6.1 Llogaritjet. Interesi, Tarifa e Zotimit Financiar, kamatëvonesa sipas nenit 6.5 (Kamatëvonesa), kompensimi si shumë e plotë për shumat e vonuara sipas nenit 6.6 (Kompensimi si shumë e plotë), Kompensimi i Mospranimi dhe Tarifa e Parapagimit llogariten në bazë të vitit kalendarik prej 360 ditësh me muaj me 30 ditë.

6.2 Data e kërkueshme. Nëse pagesa që do të shlyhet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje bie në një datë që nuk është Datë Bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në Datën e ardhshme Bankare. Nëse Data e ardhshme Bankare bie brenda muajit të ardhshëm kalendarik, kjo pagesë do të kryhet në Datën e fundit Bankare të muajit kalendar aktual.

6.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi çlirohet nga detyrimet e pagesës lidhur me këtë Marrëveshje nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse të jenë kredituar në KfW, në disponim të lirë dhe pa asnjë zbritje në euro, dhe jo më vonë se ora 10.00 e paradites në *Frankfurt am Main*, Republikën Federale të Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në *Frankfurt am Main*, Republikën Federale të Gjermanisë, me



numër IBAN: DE09 5002 0400 3102 5608 01, duke caktuar datën e kërkueshme si referencë shtesë (ref. VVVVMMDD).

6.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë asnjë të drejtë për mbajtjen ose kompensimin e të drejtave të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur këto të drejta njihen nga një vendim përfundimtar ose nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

6.5 Kamatëvonesa. Nëse ndonjë këst pagese ose parapagimi sipas nenit 5.4 (Parapagimi) nuk është vënë në dispozicion të KfW-së kur bëhet i kërkueshëm, KfW-ja mund të vendosë kamatëvonesë, pa njoftim paraprak, me një normë prej 200 pikë bazë mbi normën e interesit në vit, të përcaktuar në nenin 4.1 (Interesi), për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën e kreditimit të këtyre pagesave në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Kjo kamatëvonesë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së.

6.6 Kompensimi me shumë të plotë. KfW-ja mund të kërkojë, pa njoftim paraprak, kompensim me shumë të plotë të shumave të vonuara (me përjashtim të kësteve të pagesës dhe parapagimeve të përmendura në nenin 6.5 (Kamatëvonesa), nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës, me një normë prej 200 pikë bazë mbi Normën Fikse të Interesit në vit, sipas nenit 4.1. Kompensimi me shumë të plotë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të tregojë se nuk ka pasur asnjë dëmtim ose që dëmtimet ishin më të vogla sesa kompensimi me shumë të plotë.

6.7 Kompensimi. KfW-ja gëzon të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe në kuadër të marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

6.8 Llogaritjet e kryera nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja për shumën e kërkueshme lidhur me këtë Marrëveshje Huaje përbëjnë provë *prima facie* (*Anscheinsbeweis*).

7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, nga Republika Federale e Gjermanisë para disbursimit të parë.

8. Paligjshmëria

Nëse në çdo juridiksion të zbatueshëm bëhet e paligjshme për KfW-në për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Marrëveshje ose për të financuar ose mbajtur Huan, KfW-ja do të njoftojë Huamarrësin se:

a) zotimi financiar i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) Huamarrësi do të paguajë vetëm shumën e disbursuar dhe që nuk janë shlyer ende në datën e caktuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar për Huamarrësin (jo më parë se ditën e fundit të çdo periudhe lehtësuese të zbatueshme, të lejuar me ligj).

Për të shmangur çdo dyshim, çdo anulim do të jetë objekt i nenit 2.6 (Tarifa e Mospranimi) dhe çdo pagesë e Huas përbën parapagim dhe do të jetë objekt i dispozitave të përcaktuara në nenin 5.4 “c” (Tarifa e Parapagimit) dhe “d” (Shumat e kërkueshme).

9. Kostot dhe tarifat publike

9.1 Ndalimi i zbritjeve dhe ndalesave. Huamarrësi i kryen të gjitha pagesat në kuadër të kësaj Marrëveshjeje pa zbritje të taksave, tarifave ose kostove të tjera publike. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose nga shkaqe të tjera që t'i kryejë këto zbritje ose ndalesa për pagesat, Huamarrësi do të paguajë çdo shumë shtesë të nevojshme, në mënyrë që KfW-ja të marrë në mënyrë të plotë të gjitha shumën e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe tarifave.

9.2 Kostot. Huamarrësi mbulon të gjitha kostot dhe shpenzimet që mblidhen lidhur me disbursimin dhe pagimin e Huas, veçanërisht remitancat dhe kostot e transfertave (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që mblidhen lidhur me mbajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo dokument tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje, si dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj.



9.3 Taksat dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi i mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që paguhën jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, lidhur me përmbylljen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja jep paradhënie për këto taksa dhe pagesa, Huamarrësi i transferon ato, pa vonesë, me kërkesë të KfW-së, në llogarinë e caktuar në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) ose në një llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

10. Detyrimet e veçanta

10.1 Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë. Huamarrësi, i përfaqësuar nga MZP-ja:

a) do të përgatitë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Projektin, në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, në pajtim me standardet mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në pajtim me konceptimin e Projektit të rënë dakord ndërmjet MZP-së dhe KfW-së;

b) do t'ia caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsulentë të kualifikuar dhe të pavarur ose konsulentëve, dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) do të përmbushë kurdohërë dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të sigurojë financimin e plotë të Projektit dhe do t'i vërë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga kjo Hua; dhe

e) do të mbajë ose sigurojë mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta, duke treguar në mënyrë transparente të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

f) do t'i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së që të analizojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me zbatimin e Projektit, dhe të kryejnë vizita për Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse;

g) do t'i japë KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe regjistrat mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së;

h) me nismën e vet, do t'i përcjellë menjëherë:

i. KfW-së çdo pyetje që i drejtohet Huamarrësit nga OECD-ja ose anëtarët e saj, në kuadër të së ashtuquajturës “Marrëveshjes për Transparencën e Krediteve të Pakushtëzuara” (ODA) pas dhënies së kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojnë përgjigjen ndaj këtyre ankesave me KfW-në; dhe

ii. do të informojë KfW-në për çdo apo të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

10.2 Detajet e zbatimit të Projektit. Huamarrësi, i përfaqësuar nga MZP-ja dhe KfW-ja përcaktojnë detajet, lidhur me nenin 10.1 (Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë), nëpërmjet një Marrëveshjeje të Veçantë, e cila nënshkruhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia e Tiranës, pasi të jetë lexuar dhe dakordësuar.

10.3 Zotimi për Përmbushje. Huamarrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 2 (Akti i Përputhshmërisë).

10.4 Klasifikimi *Pari Passu*. Huamarrësi garanton dhe siguron se detyrimet e tij, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, renditen ose përmbushen të paktën *pari passu* me të gjitha Borxhet e tjera të Jashtme që nuk janë të siguruara apo të varura, dhe Huamarrësi sigurohet, deri në masën e lejuar me ligj, që ky klasifikim të jetë i mundur edhe për Borxhin e Jashtëm të pasiguarur dhe jo të varur në të ardhmen. Në këtë Marrëveshje, “Borxh i Jashtëm” nënkupton detyrimin e Huamarrësit i cili:

i. rregullohet nga një sistem ligjesh, përveç ligjit të vendit të Huamarrësit; ose

ii. është i pagueshëm në një monedhë tjetër përveç asaj të vendit të Huamarrësit; ose

iii. është i pagueshëm ndaj një personi të themeluar, me zyra qendrore, vendbanim ose seli jashtë vendit të Huamarrësit.

10.5 Barrët. Huamarrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk krijon ose nuk lejon asnjë Barrë mbi asetet e Projektit pa miratimin paraprak të KfW-së. Në këtë Marrëveshje, “Barrë” nënkupton çdo hipotekë, garanci, zotim, peng, kalim ose transferim përmes garancisë, hipotekimit ose interesit të garancisë, dhe çdo marrëveshje apo rregullim tjetër, efekti i së cilës është krijimi i



garancisë apo i një të drejte që i jep përparësi pagesës, lidhur me çdo detyrim që mund të ketë personi.

Ky detyrim nuk zbatohet:

a) për Barrët ekzistuese dhe të dakordësuara në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të bëra me dije KfW-së përpara Marrëveshjes;

b) për Barrët që janë krijuar zakonisht gjatë rrjedhës së zakonshme të punës sipas rregullimeve kontraktuale ligjore ose të posaçme për të siguruar shlyerjen e detyrimeve (me përjashtim të detyrimeve të Huas) kundrejt furnizuesve ose ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. mbajtja e titujve në fuqi dhe barrët ligjore); ose

c) për Barrët ekzistuese në kohën e përvetësimit/sigurimit të aseteve, me kusht që këto barrë të hiqen brenda tre muajsh pas përvetësimit/sigurimit.

Nëse Huamarrësi, nëpërmjet MZP-së, i jep ose autorizon dhënien e garancisë ose të të drejtave të tjera për palët e treta, duke i dhënë mundësinë kësaj pale të tretë që të kërkojë përmbushjen preferenciale të pretendimeve kundër çdo aseti të Projektit të Huamarrësit, KfW-ja mund ta kushtëzojë pëlqimin që do t'i japë Huamarrësit, duke i dhënë KfW-së garanci (shtesë) në të njëjtin nivel që ka garantuar pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit në këtë Marrëveshje Huaje.

10.6 Shitja e aseteve. Pa pëlqimin paraprak të KfW-së, Huamarrësi nuk do të shesë asetet e Projektit nëpërmjet MZP-së.

11. Zgjidhja e marrëveshjes

11.1 Arsyet e zgjidhjes. KfW-ja mund ta ushtrojë të drejtën e parashikuar në nenin 11.2 (Pasojat ligjore të ndodhjes së një shkakut për zgjidhje/përfundim) nëse lind një rrethanë që përbën shkak të arsyeshëm (*Wichtiger Grund*). Këtu përfshihen veçanërisht këto rrethana:

a) Huamarrësi nuk i përmbush detyrimet e tij të pagesës ndaj KfW-së, kur bëhen të kërkueshme;

b) shkelen detyrimet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje të veçantë, si dhe çdo marrëveshjeje tjetër shtesë të detyrueshme me ligj, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;

c) kjo Marrëveshje, ose një pjesë e saj nuk ka më efekt detyrues mbi Huamarrësin ose zbatimin i

saj nuk mund të bëhet më i detyrueshëm për Huamarrësin;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim apo garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e Huas, rezulton e rreme, e gabuar dhe e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Huamarrësi nuk mund të vërtetojë që shumat e Huas janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) Huamarrësi nuk është më në gjendje të vijojë kryerjen e pagesave ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon negociatat me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për një moratorium, heqjen dorë nga borxhet e mbetura ose zgjidhjen apo ndërprerjen e shërbimit të borxhit;

h) KfW-ja gëzon të drejtën të kërkojë pagimin e grantit të ofruar në kuadër të Marrëveshjes së Grantit të KIBP-së ose t'i pezullojë disbursimet.

11.2 Pasojat ligjore të ndodhjes së shkakut për zgjidhje. Nëse është shfaqur një prej shkaqeve të përmendura në nenin 11.1 (Arsyet për përfundim) të kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja mund ta ndërpresë menjëherë disbursimin sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 11.1.a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 11.1 (Arsyet për përfundim) nuk është zgjidhur brenda një afati të caktuar nga KfW-ja, i cili nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje Huaje ose pjesë të saj me pasoja që detyrimet e kësaj Marrëveshjeje të shuhen, dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerje të plotë ose të pjesshme të Shumës së Mbetur të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e mbetura sipas kësaj Marrëveshjeje. Neni 6.5 (Kamatëvonesa) dhe 6.6 (Kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

11.3 Kompensimi i dëmeve. Në rast se kjo Marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë Kompensimin për Mospranimin, sipas nenit 2.6 (Kompensimi i Mospranimit) dhe/ose Tarifës së Parapagimit në pajtim me nenin 5.4.c (Tarifa e Parapagimit).



12. Përfaqësimet dhe deklaratat

12.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë e përfaqëson Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Personat e caktuar prej ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të autorizuar nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij e përfaqësojnë Huamarrësin në të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Projekti dhe kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar për atë datë.

12.2 Adresat. Njoftimet dhe deklaratat në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në kopje origjinale. Çdo njoftim ose deklaratë e bërë në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany (Gjermani)

Për Huamarrësin: Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe
Ekonomisë
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë

13. Publikimi dhe Transferimi i Informacionit lidhur me Projektin

13.1 Publikimi i informacionit që lidhet me projektin nga KfW-ja. Për të përmbushur parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post*) për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/en>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose palët e treta në përputhje me nenin 13.3 (Transferimi i informacionit në lidhje me Projektin për Palët e Treta) më poshtë), për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit, nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Projekt ose në financimin e tij, të tilla si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhëna personale për personat fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

13.2 Transferimi i informacionit në lidhje me Projektin, për palët e treta. KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur, për Projektin dhe mënyrën se si financohet gjatë Periudhës së Plotë, me subjektet e mëposhtme, veçanërisht për të garantuar transparencën dhe efikasitetin:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët e Kushteve të Përgjithshme, datë 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (FPEBP);
- f) institucionet administruuese të EWB/JF-së;
- g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

13.3 Transferimi dhe publikimi i informacionit në lidhje me Projektin, për palët e treta. Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë, me subjektet e mëposhtme që botojnë artikuj lidhur me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Nismës së Transparencës të Ndihmës



Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html);

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html>);

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://www.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<https://www.deval.org/en/>);

e) palët e Kushteve të Përgjithshme, datë 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (“FPEBP”);

f) institucionet administruuese të FPEBP-së;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

13.4 Transferimi i informacionit në lidhje me Projektin për palët e treta (duke përfshirë publikimin nga këto palë). KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë të palët e tjera të treta, për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Huamarrësit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Huamarrësit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 13.1 (Publikimi i informacionit të lidhur me Projektin nga KfW-ja), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t’iu transferojë informacion palëve të treta nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore, ose për të ruajtur dhe mbrojtur pretendimet dhe të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë Bankare. Kur përmendet në këtë Marrëveshje termi “Ditë Bankare” nënkupton çdo ditë përveç të shtunës ose të dielës, në të cilën bankat tregtare në *Frankfurt am Main*, Republika Federale e Gjermanisë, janë të hapura

për biznes të përgjithshëm.

14.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje është *Frankfurt am Main*, Republika Federale Gjermane.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj Marrëveshjeje e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërish të vlefshme që i afrohet sa më shumë që të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo boshllëk në dispozita, me një dispozitë ligjërish të vlefshme që i afrohet frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Forma e shkruar. Shtesat dhe ndryshimet në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet miratuar paraprakisht nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje, që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe miratim nga qeveria apo miratime të tjera.

14.5 Caktimi. Huamarrësi nuk mund të caktojë, transferojë, vërë peng ose hipotekë ndaj ndonjë pretendimi nga kjo Marrëveshje Huaje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

14.7 Afati i parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe kur KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni pa neglizhencë flagrante.

14.8 Heqja dorë nga imuniteti. Në masën që Huamarrësi, aktualisht ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet e tij pasurore, imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose një proces tjetër ligjor, dhe në masën që Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, heq dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë



Marrëveshje Huaje në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

Me përjashtim të disa rasteve, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e ndonjë vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i. “mjediset e misionit”, të tashme ose të ardhshme, sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1961, “mjediset konsullore” të tashme ose të ardhme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri;

ii. çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, pikat 1–3, e ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii. çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë, sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore

a) *Arbitrazhi*. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje

Huaje zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

i. Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), që ndryshohet herë pas here;

ii. Gjykimet në arbitrazh kryhen në *Frankfurt am Main*. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

14.10 *Hyrja në fuqi dhe efektet*. Kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi jo më parë se Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që procedurat e brendshme ligjore, që Huamarrësi duhej të përmbushte, janë plotësuar (data e marrjes në KfW).

Në rast se kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi gjashtë muaj pas datës së nënshkrimit të saj ose pas kalimit të afateve të tjera të rëna dakord nga KfW-ja, KfW-ja do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga kjo Marrëveshje duke i dorëzuar Huamarrësit njoftim me shkrim.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
Sot, më 30 shtator 2021

KfW

Emri: Brit Horschke
Pozicioni: KfW COUNTRY DIRECTOR

Emri: Niels Kemper
Pozicioni: PROJECT MANAGER

Tiranë,
Sot, më 30 shtator 2021

Republika e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë

Emri: Delina Ibrahimaj
Pozicioni: MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË



Shtojca 1 Grafiku i disbursimeve

GRAFIKU MË I SHPEJTË I MUNDSHËM I DISBURSIMEVE

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (Data e hyrjes në fuqi të përfundimit të periudhës, në përputhje me listën më poshtë), Huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në nivelin që nuk tejkalon shumën e akumuluar të disbursimeve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Periudha	Data e hyrjes në fuqi të fillimit të periudhës (përfshirë)	Data e hyrjes në fuqi të përfundimit të periudhës (përfshirë)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (e akumuluar) (të gjitha shifrat në euro)
1	30.12.2021	1.1.2022	200.000,00
2	1.1.2022	1.7.2022	2.200.000,00
3	1.7.2022	1.1.2023	7.200.000,00
4	1.1.2023	1.7.2023	12.200.000,00
5	1.7.2023	1.1.2024	17.200.000,00
6	1.1.2024	1.7.2024	19.200.000,00
7	1.7.2024	30.12.2026	20.000.000,00

Shtojca 2 Akti i përputhshmërisë

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë kanosëse” dëmtimi apo lëndimi, ose kërcërimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive” premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person, me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose të shmangies së një detyrimi.

“Praktikë penguese” i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore, ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim

zyrtar mbi akuzën e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse, praktike të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose të kryejë hetimin; apo ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse, ose praktike të fshehtë.

“Person” një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme” çdo praktikë kanosëse, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike penguese (sipas termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje) që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së apo zbatimit të saj.

“Sanksionet” sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Organ sanksionues” Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.



“Listë e sanksioneve” çdo listë e personave, grupeve, apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. ZOTIMET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Nëpërmjet MZP-së, Huamarrësi:

a) i vë në dispozicion KfW-së, në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Huamarrësin;

b) i paraqet menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e lidhura me Projektin e Huamarrësit dhe kontraktuesve (nënkontraktuesve) të saj dhe palëve të tjera të lidhura, që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar praktikën e sanksionueshme, pastrimin e parave ose/dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Huamarrësin, të nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në, në kohë dhe me nismën e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) bën të mundur që KfW-ja dhe agjentët e saj të inspektojnë në çdo kohë të gjithë dokumentacionin tjetër të Projektit të Huamarrësit dhe të (nën)kontraktuesve të tij, dhe palëve të tjera përkatëse dhe të vizitojnë Projektin, dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce.

3. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Huamarrësit, Huamarrësi deklaron që asnjë nga personat që veprojnë në lidhje me projektin në emër të Huamarrësit, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në ndonjë praktikë të sanksionueshme, të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Sigurimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepet për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të pagesës së interesit, në çdo rast duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Huamarrësi merr përsipër, menjëherë pasi Huamarrësi ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të konstatuar nëse ka ndodhur një incident i tillë i pajtueshmërisë. Huamarrësi, në veçanti, do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të ofrojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Huamarrësi nuk do të hyjë në ndonjë transaksion ose nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Projektin, që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

DEKRET

Nr. 13458, datë 4.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 4/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *KfW Frankfurt am Main* (KfW) për rehabilitimin me efikasitet energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

**VENDIM****Nr. 100, datë 9.2.2022**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2022,
MIRATUAR PËR KOMISIONIN
QENDROR TË ZGJEDHJEVE,
PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE TË
PJESSHME PËR ORGANET E
VETËQEVERISJES VENDORE, TË
DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 87, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i shtohet fondi prej 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 6 mars 2022.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

UDHËZIM**Nr. 1, datë 19.1.2022**

**PËR ORGANIZIMIN DHE
ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE DHE TË
MATURËS SHTETËRORE
PROFESIONALE 2022**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7 dhe nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:**I. Matura Shtetërore**

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2022, për arsimin e mesëm të lartë të jenë:

- a) provime të detyruara: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe gjuhë e huaj;
- b) një provim me zgjedhje.

2. Provime të detyruara

a) Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, gjuhë e huaj) për të gjithë maturanët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

b) Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

c) Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht dhe turqisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

3. Provimi me zgjedhje

- a) lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Kimi;
Fizikë;
Biologji;
Histori;
Gjeografi;



Qytetari dhe psikologji;

Filozofi dhe sociologji;

Ekonomi;

Histori Arti;

Histori Muzike;

Histori Baleti;

b) programet orientuese të lëndëve me zgjedhje, të jenë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z;

c) programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje;

d) maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

5. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapin atë që të pajisen me diplomë.

6. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2021 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

7. Datat për provimet e Maturës Shtetërore 2022 të jenë:

a) Gjuhë e huaj	9 qershor 2022;
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi	11 qershor 2022;
c) Matematikë	17 qershor 2022;
d) Provimi me zgjedhje	24 qershor 2022.

8. Provimet e Maturës Shtetërore 2022 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

9. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2022 hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

10. Testi për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2022 vlerësohet me 60 pikë maksimale.

11. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2022, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

12. Zyrat vendore arsimore parauniversitare (ZVAP-të) pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2021–2022 i pasqyrojnë ato në portalin e Maturës Shtetërore *online*, sipas udhëzimit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista

dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

13. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore, sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

14. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*lingua e literatura italiana*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afat kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 9 qershor 2022 dhe zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3), për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në Memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 1 qershor 2022 para një komisioni të ngritur nga palët.

15. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (*DEL F B2 scolaire*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 25 maj 2022, në shkollat përkatëse.

16. Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2022 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2022.

17. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2022 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

II. Matura Shtetërore Profesionale

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2022, për shkollat e mesme profesionale, të jenë:

Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar”, sipas kualifikimit profesional që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.

2. Datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2022, të jenë:

a) Gjuhë e huaj	9 qershor 2022;
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi	11 qershor 2022;
c) Matematikë	17 qershor 2022;
d) Teori Profesionale e Integruar	24 qershor 2022.

3. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të



arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

4. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021) që kanë rezultuar jo kalues në provimin D3, duhet ta rrijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të

maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rrijapin provimin e detyruar D3.

5. Lista e provimeve të detyruara të Teorisë Profesionale të Integruar, sipas kualifikimit profesional që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale, është:

Nr.	<i>Kualifikimi profesional</i>
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesht transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut
26	Zhvillim <i>website</i>
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike <i>software-sh</i> (Hermann Gmeiner)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanik (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji



37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot-GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji Bujqësore

6. Provimet e detyruara “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj e parë”, dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

7. Provimet e detyruara të Teorisë Profesionale të Integruar, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara në faqet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

8. Kandidati i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

9. Kandidati që në Maturën Shtetërore të viteve 2013–2016:

a) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje;

b) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje;

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, te të cilat nuk përfshihet Teoria Profesionale e Integruar, duhet të japë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

10. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t’u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provimin e Teorisë Profesionale të Integruar, ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshëm për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

Faqe | 2692

III. Dispozitat e fundit

1. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2022 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit (MAS), zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Sekretari i Përgjithshëm i MAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat arsimore vendore parauniversitare, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCIVE DHE
EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 22, datë 2.2.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015,



“Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit, z. Enton Sadiku.

2. Z. Enton Sadiku i delegohen kompetencat, si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (e ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 4.2.2022 deri më 11.2.2022.

4. Z. Enton Sadiku nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta, një për protokoll/arkivin dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

NJOFTIM
Nr. 1395, datë 3.2.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndryshuese, me shkëmbim notash, e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi, do të hyjë në fuqi më 1 prill 2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 6, datë 2.2.2022

PËR PEZULLIMIN E SHPËRNDARJES SË FITIMIT NGA BANKAT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pikat 2 dhe 3; të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 66/1, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të pezullojë, deri më datë 31 dhjetor 2022, shpërndarjen nga ana e bankave të fitimit të vitit 2021 dhe të fitimit që do të realizohet gjatë vitit 2022.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.



5. Ky vendim i komunikohet Departamentit të Stabilitetit Financiar, Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Departamentit të Politikës Monetare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 7, datë 2.2.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR REGJISTRIN PUBLIK TË
OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË
PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c” dhe “P”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 16, pika 4, nenit 21, pika 2 dhe nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për krijimin, mirëmbajtjen dhe publikimin e regjistrit publik, si dhe subjektet e përcaktuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje, për paraqitjen e informacionit të nevojshëm, për t’u përfshirë në regjistër.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE

**PËR REGJISTRIN PUBLIK TË OFRUESVE
TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE**

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i subjekteve dhe të dhënave që do të përmbajë regjistri publik i ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe agentëve të tyre.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c” dhe “P”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 4, nenit 21, pika 2 dhe nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (i cili, në vijim në këtë rregullore, do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”).

Neni 3
**Subjektet e regjistrit të ofruesve të
shërbimeve të pagesave**

1. Banka e Shqipërisë krijon regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave, i cili përmban të dhëna për:

a) institucionet e pagesave, sipas përkufizimit të nenit 5, pika 13, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

b) institucionet e parasë elektronike;

c) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, sipas përcaktimit të nenit 28, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

d) agentët e subjekteve të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni;

e) ofruesit e shërbimeve, që përfitojnë nga përjashtimet, sipas parashikimeve të nenit 4, shkronja “g”, nënpikat “i” e “ii”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, në rast se Banka e Shqipërisë merr një vendim për mosvazhdimësinë e përjashtimit nga ligji, në përputhje me kërkesat e nenit 31, pika 2, të këtij ligji;

f) ofruesit e shërbimeve, të përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit “Për shërbimet e



pagesave”, sipas nenit 4, shkronja “h”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 4

Regjistrimi i institucioneve të licencuara dhe agentëve të tyre

1. Institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, si dhe agentët e tyre regjistrohen në një listë të veçantë nga subjektet e tjera të parashikuara në shkronjat “c”, “e” dhe “f”, të nenit 3, të kësaj rregulloreje.

2. Për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të licencuara, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e subjektit (sipas përcaktimit në licencë);

b) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

c) adresën e selisë qendrore të subjektit;

d) kapitalin fillestar të paguar;

e) identitetin (emrin) e aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe përqindjet e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;

f) identitetin e administratorit/ëve dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit;

g) numrin dhe datën e licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë;

h) adresën e degëve (nëse ka);

i) listën e veprimtarive/shërbimeve të lejueshme, që kryen subjekti;

j) numrin dhe datën e vendimit për shfuqizimin e licencës nga Banka e Shqipërisë;

k) numrin dhe datën e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive, nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë regjistron të dhënat e përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a” deri në “i”, të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e licencimit, si dhe të dhënat mbi shfuqizimin e licencës apo pezullimin e një ose disa veprimtarive, të parashikuara në shkronjat “j” dhe “k”, të pikës 2, të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit përkatës.

4. Banka e Shqipërisë, për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a” deri në “i”, të këtij neni, të kryer nga subjekti, përditëson këto të dhëna në regjistrin publik, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

5. Për agentët e institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e agentit;

b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe/ose të shërbimeve të parasë elektronike që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;

c) shërbimet e pagesave ose shërbimet e parasë elektronike që do të kryejë agjenti.

6. Banka e Shqipërisë regjistron agjentin dhe të dhënat e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të parashikuar në pikën 1, të nenit 21, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, nga institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike.

Vetëm pas regjistrimit sipas kësaj pike, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave dhe/ose të shërbimeve të parasë elektronike.

Neni 5

Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë

1. Për ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e ofruesit;

b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e subjektit;

c) numrin dhe datën e vendimit për regjistrim, të dhënë nga Banka e Shqipërisë;

d) adresën e degëve (nëse ka);

e) listën e shërbimeve të lejueshme që kryen subjekti;

f) numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik.

2. Banka e Shqipërisë regjistron ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë dhe të dhënat e përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a” deri në “e” të këtij neni, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për regjistrim, siç parashikohet në nenin 50, pika 6, të rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, dhe për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në pikën 1,



shkronjat “a” deri në “e” të këtij neni, të kryer nga subjekti, përditëson këto të dhëna në regjistrin publik, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit. Banka e Shqipërisë përfshin në regjistrë, numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë nga regjistri publik, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

3. Për agjentët e ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e agjentit;

b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;

c) shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti.

Banka e Shqipërisë regjistron agjentin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë pikë, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes nga ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, të dokumentacionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 54, të rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”.

Vetëm pas regjistrimit sipas kësaj pike, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave.

Neni 6

Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet

1. Për subjektet e parashikuara në shkronjat “e” dhe “f”, të nenit 3 të kësaj rregulloreje, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e ofruesit;

b) identitetin e administratorit të subjektit;

c) numrin dhe datën e vendimit për regjistrim;

d) veprimtaritë që kryen subjekti;

e) numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik.

2. Banka e Shqipërisë regjistron të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit për regjistrimin në regjistrin publik, si dhe përditëson këto të dhëna, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, për çdo ndryshim që mund të ndodhë në të dhënat e mësipërme. Banka e Shqipërisë përfshin në regjistrë, numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjekteve të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

Neni 7

Publikimi i regjistrit të ofruesve të shërbimeve të pagesave

Regjistri i ofruesve të shërbimeve të pagesave publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe përditësohet e administrohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Institucionet e parasë elektronike, të licencuara në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të vazhdojnë të mbeten të regjistruara në regjistrin e subjekteve të licencuara, të parashikuar në nenin 128 të këtij ligji, deri në momentin e pajisjes me aneksin e përditësuar të licencës për shërbimet e pagesave që ushtrojnë, siç parashikohet në nenin 99, pika 6, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, dhe më pas do të regjistrohen në regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në këtë rregullore.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko



Aneks 1

Regjistri i ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike

<u>Lista e Shërbimeve të pagesave sipas aneksit 1 të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u>	
1. Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.	
2. Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.	
3. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:	
a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;	
b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;	
c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.	
4. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:	
a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;	
b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese ose nga një pajisje e ngjashme;	
c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.	
5. Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave.	
6. Dërgesat e parave.	
7. Shërbimi i inicimit të pagesës.	
8. Shërbimi i informimit të llogarisë.	
<u>Lista e shërbimeve, sipas nenit 4, shkronja "g", nënpikat "i" dhe "ii" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u>	
gj) Shërbime të bazuara në instrumentet specifike të pagesave që mund të përdoren vetëm në një mënyrë të kufizuar, që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:	
i. instrumentet që lejojnë mbajtësin të blejë mallra ose shërbime vetëm në vendndodhjet e emetuesit ose brenda një rrjeti të kufizuar të ofruesve të shërbimeve, në bazë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë tregtare me një emetues profesional;	
ii. instrumentet, të cilat mund të përdoren vetëm për të blerë një numër shumë të kufizuar mallrash ose shërbimesh.	
<u>Lista e shërbimeve, sipas nenit 4, shkronja "h" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u>	
h) Transaksione të pagesave nga një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose shërbime të ofruara krahas shërbimeve të komunikimeve elektronike për një pajtimtar të rrjetit ose të shërbimit:	
i. për blerje të shërbimeve digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumin e shërbimeve digjitale dhe pasqyruar në faturën përkatëse; ose	
ii. për të realizuar nga ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike dhe për të pasqyruar në faturën përkatëse, në kuadër të një aktiviteti bamirësie ose për blerjen e biletave.	



Institucionet e pagesave

Të dhëna mbi subjektin										
Emri i subjektit	NUIS	Numri dhe data e licencës	Adresa e selisë qendrore	Kapitali fillestar i paguar	Emri i aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe % e pjesëmarrjes në kapital	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit	Adresa e degëve	Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime pagesash, sipas aneksit 1, të ligjit nr. 55/2020)	Numri dhe data e vendimit për shfuqizimin e licencës	Numri dhe data e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive

Agjentët e institucioneve të pagesave

Të dhëna mbi agjentët					
Emri i Institucionit të pagesave	Emri i agjentit	NUIS-i	Adresa e agjentit	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave	Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti



Institucionet e parasë elektronike

Të dhëna mbi subjektin											
Emri i subjektit	NUIS-i	Numri dhe data e licencës	Adresa e selisë qendrore	Kapitali fillestar i paguar	Emri i aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe % e pjesëmarrjes në kapital	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit	Adresa e degëve	Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime të parasë elektronike)	Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime pagesash, sipas aneksit 1, të ligjit nr. 55/2020)	Numri dhe data e vendimit për shfuqizimin e licencës	Numri dhe data e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive

Agjentët e institucioneve të parasë elektronike

Të dhëna mbi agjentët						
Emri i Institucionit të parasë elektronike	Emri i agjentit	NUIS-i	Adresa e agjentit	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose të parasë elektronike	Lista e shërbimeve të parasë elektronike që do të kryejë agjenti	Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti



Ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë

Të dhëna mbi subjektin							
Emri i subjektit	NUIS-i	Numri dhe data e vendimit për regjistrim	Adresa e selisë qendrore	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit	Adresa e degëve	Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen	Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik

Agjentët e ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë

Të dhëna mbi agjentët					
Emri i ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë	Emri i agjentit	NUIS-i	Adresa e agjentit	Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave	Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti



Ofruesit e shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet sipas nenit 4, shkronja “gj”, nënpikat “i” dhe “ii”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”

Të dhëna mbi subjektin						
Emri i subjektit	NUIS-i	Numri dhe data e vendimit për regjistrim	Adresa e selisë qendrore	Emri i administratorit të subjektit	Veprimtaritë që kryen ofruesi	Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik

Ofruesit e shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet sipas nenit 4, shkronja “h”, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”

Të dhëna mbi subjektin						
Emri i subjektit	NUIS-i	Numri dhe data e vendimit për regjistrim	Adresa e selisë qendrore	Emri i administratorit të subjektit	Veprimtaritë që kryen ofruesi	Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik



VENDIM

Nr. 13, datë 26.1.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ALBGAS” SHA PËR SHTYRJE TË
AFATIT TË VENDIMARRJES FINALE
TË BORDIT TË ERE-s, PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAS”
SHA NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË
HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 128/1 prot., datë 21.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- ERE, me vendimin nr. 195, datë 22.9.2021, ka vendosur për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri më datë 20.1.2022. Në kuptim të këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese, mbi të gjithë dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim, me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s nëpërmjet postës zyrtare elektronike, më datë 20.1.2022, duke argumentuar se, në kuadër të

plotësimit të dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, aktualisht po punon mbi raportin final “WB20-ALB-ENE-01 Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage”, i cili përmbush kërkesat e paplotësuara për këtë procedurë. Këtë draftoport shoqëria “Albgaz” sh.a. e ka depozituar edhe në ERE. Në këto kushte, shoqëria kërkon mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale, për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror të “Albgaz” sh.a., deri më datë 20.12.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, brenda afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195, datë 22.9.2021, dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “Albgaz” sh.a. për të plotësuar kushtet respektive, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimarrjes, për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri më datë 20.12.2022.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

3. Ky vendim i shtrín efektet duke filluar nga data 20.1.2022.



4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 14, datë 26.1.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128/2 prot., datë 21.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 1.10.2021, vendosi:

“Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur

të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”.

- Në lidhje me plotësimin e kushtit që ka të bëjë me “Lejet dhe autorizimet mjedisore”, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 93 prot., datë 21.6.2021 protokolluar në ERE me nr. 764 prot., datë 21.6.2021, ka bërë me dije se është pajisur me “Vendim për VNM-në paraprake”, dokument i depozituar në ERE dhe i nevojshëm për aplikim për pajisje me leje mjedisore, e cila mbetet në proces për t’u marrë gjatë vitit 2022.

- Për sa i përket kushtit që ka të bëjë me “Certifikatën e sigurimit”, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se është parashikuar në buxhetin e saj për vitin 2022 pagesa përkatëse dhe do të mbyllet përgjatë këtij viti.

- Shoqëria kërkon shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit që ka të bëjë me depozitim në ERE të “Certifikatës së sigurimit”, në një datë me atë të kushtit të vendosur për depozitim në ERE të “Lejeve dhe autorizimeve mjedisore”, pra më datë 20.1.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit përkatës, është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 1.10.2021, dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “Albgaz” sh.a. për të plotësuar kushtet e sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE Lejet dhe Autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit, në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 15, datë 26.1.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative

të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128/2 prot., datë 21.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 1.10.2021, vendosi:

“Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.

- Në lidhje me plotësimin e kushtit që ka të bëjë me “Lejet dhe autorizimet mjedisore”, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 93 prot., datë 21.6.2021, protokolluar në ERE me nr. 764 prot., datë 21.6.2021, ka bërë me dije se është pajisur me “Vendim për VNM-në paraprake”, dokument i depozituar në ERE dhe i nevojshëm për aplikimin për pajisje me leje mjedisore, e cila mbetet për t'u marrë gjatë vitit 2022.

- Për sa i përket kushtit që ka të bëjë me “Certifikatën e sigurimit”, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se është parashikuar në buxhetin e saj për vitin 2022 pagesa përkatëse dhe do të mbyllet përgjatë këtij viti.

- Shoqëria kërkon shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit që ka të bëjë me depozitimin në ERE të “Certifikatës së sigurimit”, në një datë me atë të kushtit të vendosur për depozitimin në ERE të “Lejeve dhe autorizimeve mjedisore”, pra më datë 20.1.2022.



- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarrimit të afatit.”.

- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 1.10.2021, dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “Albgaz” sh.a. për të plotësuar kushtet e sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 16, datë 26.1.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 109 prot., datë 20.1.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 36/5 prot., datë 17.1.2022, dhe *email*-in e datës 18.1.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin e korrigjuar, si dhe sqarime lidhur sasinë e cila ka shërbyer për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.



- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënie në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s

nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Dhjetor 2021

Dhjetor 2021		Sipas aplikimit të FSHU sh.a.	Sipas Përlogaritjeve të ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	26.880
Pr	Kthimi për rrishtin e përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81
Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante		Leke/kWh	27.69
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh	31.73

- Bazuar në çdo element të formulës përlogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikim, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2021, të jetë 31.73 lekë/kwh.

- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDOSI:

KRYETAR
Petrit Ahmeti

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 31.73 lekë/kwh, për muajin dhjetor 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të

KËRKESË
Nr. 58/3, datë 7.2.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban i ambienteve rekreative, restaurimi i fasadave të objekteve, në lagjen ‘5 Shtatori’, Çorovodë”.



Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Skrapar.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, të paraqitni pretendimet tuaja, nëse keni, pranë Bashkisë Skrapar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4,223,038 (katër milionë e dyqind e njëzet e tre mijë e tridhjetë e tetë) lekë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
“RIKUALIFIKIM URBAN I AMBIENTEVE REKREATIVE, RESTAURIMI I FASADAVE TË OBJEKTEVE, NË LAGJEN ‘5 SHTATORI’ ÇOROVODË”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore										Vlerësimet për shpronësim											Shënimet (bujësi, hipotekë, burime pasurisë etj.)	
														Are			Tërull			Ndërtesë			Kultura bujqësore dhe druftorë			Vlera totale (lekë)
	Emër	Adesi	Mbitemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Are (m²)	Tërull (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e druftorëve (lekë)		
	a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n	o	p=n*o	q	r	s=q*r	t	u	v	x	y	z	
1	Myqerem	Kamber	Ajallari	Çorovodë	1420	13/76	Ganzh	26			26					0		1,015	0	26	9,806	254,960			254,960	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
2	Tomor	Neshat	Bregu	Çorovodë	1420	13/78	Ganzh	32			32					0		1,015	0	32	9,106	291,377			291,377	Logjistikë sipas matjeve fshiale.
3	Kastriot	Dilaver	Kushov	Çorovodë	1420	13/30	Ganzh	20			20					0		1,015	0	20	8,519	170,384			170,384	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
4	Haziz	Shehri	Çexpi	Çorovodë	1420	13/72	Ganzh	70			70					0		1,015	0	70	9,705	679,354			679,354	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
5	Ali	Nesim	Hasanag	Çorovodë	1420	13/20	Njësi	203		203	40	8	92			0	203	1,015	206,045	40	9,122	364,879			570,924	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
6	Fatir	Hekuran	Nuclari	Çorovodë	1420	13/77	Njësi	32		32	32	8	91			0	32	1,015	32,480	32	7,914	253,232			285,712	Logjistikë sipas matjeve fshiale. Kufizimet në shkronjën "E": U vendos burimi hipotekor me shkronjën 3772/1, datë 22.6.2017.
7	1. Agim 2. Sorila	Fikri Xhelal	Ibro Ibro	Çorovodë	1420	13/71	Ganzh	15			15	8	99			0		1,015	0	15	12,014	180,209			180,209	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
8	Neshitje	Mesa	Memollari	Çorovodë	1420	13/27-N1	Njësi	36			36	8	131			0		1,015	0	36	4,173	150,237			150,237	Logjistikë sipas dokumenteve të pronësorisë.
9	Fatbardha	Qezim	Lajo	Çorovodë	1420	13/27-N2	Njësi	27			27	8	132			0		1,015	0	27	5,289	142,816			142,816	Logjistikë sipas matjeve fshiale.
10	1. Adriatik 2. Tanja	Skënder Nesim	Murati Murati	Çorovodë	1420	13/27+1-1	Apartament	42			42	2	194			0		1,015	0	42	13,260	556,900			556,900	Logjistikë sipas matjeve fshiale.
11	Sokol	Slim	Hoshia	Çorovodë	1420	13/27+2-2	Apartament	42			42	2	194			0		1,015	0	42	13,226	555,501			555,501	Logjistikë sipas matjeve fshiale.
12	1. Gerasim 2. Tefia	Qezim Sefer	Alimci Alimci	Çorovodë	1420	13/27+3-3	Apartament	42			42	2	196			0		1,015	0	42	6,716	282,092			282,092	Logjistikë sipas matjeve fshiale. Kufizimet në shkronjën E: Nuk ka

[illegible]

Shënimi. Objektet të cilat kanë sipërfaqe të matur më të madhe se sipërfaqja e referuar nga ASHK Skrapar, janë vlerësuar me kosto sipas sipërfaqes së referuar nga ASHK Skrapar. Objektet të cilat kanë sipërfaqe të matur më të vogël se sipërfaqja e referuar nga ASHK Skrapar, janë vlerësuar me kosto sipas sipërfaqes së matur.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë